



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit:22.3.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË KOMUNËS SË
GJAKOVËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Gjakovës, në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri, i mbështetur nga Ardita Salihu (udhëheqëse ekipi), si dhe Cyme Hoxhaj e Valbona Pllana (anëtarë ekipi).

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
2 Qeverisja.....	11
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	19
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	35
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	36
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak	39


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Gjakovës (më tutje: komuna) për vitin 2015, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ne dëshirojmë të falënderojmë Kryetaren e Komunës dhe stafin e saj për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me Standardet e Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorin Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat kemi menduar se janë të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me Pasqyrat Vjetore Financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 19.10.2015.

Auditimi ynë është fokusuar në:



(Më hollësisht, shih shtojcën I të këtij raporti).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015, është përcaktuar nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

“Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes” sepse nuk ishim në gjendje të konfirmojmë nëse saldo e llogarive të arkëtueshme e prezantuar në PVF në vlerë 622,000€ ishte e saktë.


Formulimi i plotë i opinionit është dhënë në hollësi tek nën kapitulli 1.2 i këtij raporti

Konkluzioni i përgjithshëm

Detajet e paraqitura në këtë raport, pasqyrojnë konkluzionin tonë të përgjithshëm, si vijon:

Komuna ka bërë përpjeke për adresimin e rekomandimeve tona dhe ushtron kontrolle në pjesën më të madhe të sistemit të kontrollit të brendshëm, por ende ekzistojnë disa fusha ku dobësitë janë të pranishme.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Regjistra jo të plotë të pasurive
komunale



Kryetarja duhet të sigurojë se procesi gjithëpërfshirës i regjistrimit të pasurive do të vazhdojë dhe brenda një afati optimal do të nxirret një regjistër përfundimtar mbi pasuritë e komunës (shih çështjen 16)

Përgjigja e Menaxhmentit për auditimin e vitit 2015

Kryetarja e Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

Ne e konsiderojmë si të kryer faktin që Kryetarja:

- Do ta shqyrtoj raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Deri në fund të muajit janar 2017, do ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2016 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne, gjithashtu, shqyrtojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar, për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

PËR KOMUNËN E GJAKOVËS

OPINIONI I PAMODIFIKUAR ME THEKSIM TË ÇËSHTJES

Ne kemi audituar Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Gjakovës për vitin e përfunduar më 31.12.2015, të cilat përfshijnë 'Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme', 'Pasqyra e Krahasimit të Buxhetit me Shumat Aktuale', Shënimet shpjeguese dhe Shpalosjet.

Sipas mendimit tonë, Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe pagesave si dhe të buxhetit të realizuar të Komunës së Gjakovës për vitin e përfunduar më 31.12.2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën Financiare të MF nr. 03/2013 për Pasqyrat Vjetore Financiare të organizatave buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa për Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të Pasqyrave Vjetore Financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga komuna dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushë në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që janë marrë, janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion.

Theksimi i çështjes

Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen se ne nuk ishim në gjendje të konfirmojmë nëse saldo e prezantuar në PVF, për llogaritë e arkëtueshme të taksave në biznes në vlerë 622,000€ është e saktë. Kjo, për arsye se databaza e komunës nuk gjeneron historikun e ngarkesave, pagesave dhe ndryshimeve në mënyrë të detajuar. Kështu, mbetet e paqartë nëse komuna ka falur një pjesë të borxheve të pambledhura, duke interpretuar gabimisht ligjin për faljen e borxheve apo duke u bazuar në dëshmitë e ATK-së për mos qarkullim të biznesit. Përveç tatimit në pronë, falja e borxheve duhet të kalojë përmes aprovimit në Kuvendin Komunal. Vlenë të përmendet se shuma në PVF 2014 ishte 1,193,000€ dhe pagesat e pranuar gjatë vitit ishin 51,561€.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

Menaxhmenti i komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të atilla, të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale, të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Personat e ngarkuar me qeverisje, si: Kryetarja, drejtorët, mbajtësit e buxhetit dhe zyrtarët financiar janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për Pasqyrat Vjetore Financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-të do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre Pasqyrave Vjetore Financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në Pasqyrat Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e

konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e Pasqyrave Vjetore Financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të Pasqyrave Financiare.

1.3 Rreziqet domethënëse në PVF

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit të datës 19.10.2015, janë identifikuar katër rreziqe për PVF-të. Këto janë rreziqe të keqdeklarimeve materiale, të cilat mund të rezultojnë në modifikim të opinionit ose në theksim të çështjes. Njëri prej tyre ka të bëjë me paraqitjen e vlerës së tërësishme të buxhetit final të donatorëve në pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, rrezik ky i cili nuk ka ndodhur. Komuna ka deklaruar saktë buxhetin final të donatorëve në PVF-të 2015.

Rreziqet tjera të mëposhtme ishin trajtuar në një masë nga komuna:

- Rreziku i keq klasifikimit të pagesave – Shkaku i mangësive në projeksionet buxhetore, ky rrezik ka ndodhur sepse ende ka shpenzime që janë ekzekutuar nga kode të gabuara ekonomike. Gjithsej 115,305€ i takojnë kategorisë Mallra dhe shërbime (MSh), por janë paguar nga kodi i Investimeve Kapitale (IK). Vlen të sqarohet se shuma prej 115,305€ ishte e aprovuar me tabelat buxhetore të Buxhetit 2015 për investime kapitale, por projektet e paraqitura në tabela, nuk përmbushin kushtet të trajtohen si projekte kapitale, dhe gabimet kanë të bëjnë me planifikimet fillestare nga komuna dhe aprovimet jo adekuate nga ana e MF.
- Rreziku i identifikimit të palëve të treta, rrezik i cili edhe është materializuar. Për shkak të mos mbledhjes me kohë të të dhënave adekuate mbi palët e treta, dy projekte gjithsej 26,957€ janë shpalosur në pasqyra, por nuk janë paraqitur në kolonën e palëve të treta. Përveç kësaj, ne kemi identifikuar një projekt tjetër i cili nuk është deklaruar në PVF, në vlerë 38,313€. Projekti është financuar nga KDC (Qendra Kosovare për Zhvillim) për qëllim të Renovimit të objektit për funksionimin e qendrës multifunktionale të bizneseve në Gjakovë. Pra, vlera e nënvlerësuar është 65,270€; dhe
- Rreziku i regjistrimit të saktë të vlerës së pronave komunale – Përkundër që komuna ka themeluar komision të veçantë për të identifikuar të gjitha kontestet me prona, ky rrezik ende ekziston meqenëse zgjidhja e këtyre kontesteve nuk varet vetëm nga komuna, por edhe veprimet e Gjykatës dhe qytetarëve.

1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Nga komuna kërkohet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren Financiare MF nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me plotësime dhe ndryshime);
- Pajtueshmërinë me kërkesat buxhetore;
- Raportimet tremujore në Kuvendin Komunal; dhe
- Planin e prokurimit dhe raportimin e progresit të investimeve kapitale mbi 10,000€.

Në kontekst të kërkesave për raportim, nuk kemi ndonjë vërejtje. Ndërsa, PVF-të 2015 përmbajnë gabimet si më poshtë:

- Neni 12- pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, kolona pagesat nga palët e të jashtme ishte nënvlerësuar 65,270€. Vetëm vlera 26,957€ është shpalosur si shënim nën nenin 12 Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme;
- Mbivlerësim i shpenzimeve për shkak të pagesave të parregullta në vlerë 15,015€ (shih çështjet 8 dhe 9);
- Komuna kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve ku nga kategoria e Investimeve Kapitale kishte bërë pagesa 115,305€ që i takojnë kategorisë Mallra dhe Shërbime dhe nuk janë shpalosur në PVF; dhe
- Shënimi 35, Llogaria e arkëtueshme nga Taksat në Biznes kishte salldo 622,000€ derisa në vitin e kaluar ishte 1,193,000€ . Por, shuma e inkasuar ishte vetëm 51,561€. Kjo diferencë e lartë mes viteve është konfuze dhe nuk ishim në gjendje të qartësojmë këtë me komunën (shih çështjen 16).

Gjetjet më lartë tregojnë që përgatitja e PVF është menaxhuar në mënyrë të dobët.

1.5 Rekomandimet

Rekomandimi 1 Prioritet i lartë - Kryetarja duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet e ngritura. Kjo, gjithashtu, duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime. Sa i përket palëve të treta, për vitin 2016 duhet të kompletohen saktë lëndët për investimet që janë bërë nga Caritas, Kost dhe Klubi Rotarian Gjakova.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për komunën që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit, meqë kjo tregon se menaxhmenti është duke i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollat. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetëvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të mëtejme të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të mbështeten nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të nxisin përmirësime pozitive; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Përkundër që ky raport përmban vërejtje për menaxhimin financiar, në komunë hasen mekanizma të një qeverisjeje të përmirësuar, veçanërisht tek raportimi menaxherial i një numri aktiviteteve. Komuna ka bërë një progres në menaxhimin e organizatës, kryesisht në reduktimin e shpenzimeve operative (duke marrë parasysh që disa fatura të paguara datojnë edhe nga vitet e mëhershme), në shlyerjen e borxheve, si dhe veprime të konsiderueshme janë ndërmarrë në ndërtimin e marrëdhënieve kontraktuale me donatorë të ndryshëm.

- Krahasuar me vitin e kaluar 2014, shpenzimet për komunal si dhe ato të reprezentacionit janë zvogëluar për 22%;
- Shpenzimet për karburantet e veturave kanë rënë për 25%;
- Borxhet e akumuluar financiare janë shlyer konsiderueshëm;
- Dhjetëra marrëveshje janë nënshkruar me donatorë të ndryshëm, për përmirësimin e infrastrukturës komunale, ngritjen e transparencës, stimulimin e ndërmarrësisë, luftimin e

korrupsionit si dhe në përmirësimin e shërbimeve për qytetarë. Shuma e donacioneve të pranuar deri tash përmes llogarisë komunale është 133,625€;

- Për shumicën e aktvitetiteve komunale zbatohen rrugë të qarta komunikimi dhe raportimi mes bartësve të njësive dhe kryetares, të përcjellura me procesverbale;

Megjithatë, përkundër zhvillimeve pozitive, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet menaxhimit të pronave komunale:

Më datë 07.08.2015, Kryetarja ka themeluar komision të veçantë për evidentimin e të gjitha pronave komunale për të identifikuar kontestet me prona, shfrytëzimin e tyre nga persona të ndryshëm pa mbështetje ligjore, si dhe shfrytëzimin e lokaleve pa kryer pagesat ndaj komunës. Deri më tani është bërë një progres i dukshëm në këtë drejtim, megjithatë kërkohet komunikim i shtuar mes Drejtorisë së Urbanizimit, Kadastrit, Kuvendit Komunal dhe shfrytëzuesve të pronave, për të evituar të gjitha parregullsitë me prona në komunë. Deri më tash ky Komision ka përfunduar punët si vijon:

1. Janë evidentuar rreth 29 banesa të cilat shfrytëzohen nga qytetarët, por nuk kanë ndonjë marrëdhënie kontraktuale me komunën;
2. Në banesat kolektive "Ndërtesa e Dibranëve" (rreth 25 banesa) si dhe "Ndërtesa e bardhë" (rreth 40 banesa) Komisioni ka evidentuar përdoruesit e këtyre banesave si dhe ka sqaruar nëse përdoruesit janë në skemë sociale, nëse ka të atillë që mund të kenë keq përdorur banesat si dhe kanë bërë vlerësimin mbi kushtet ekonomike. Më tej, shfrytëzuesit nuk kanë marrëdhënie kontraktuale me komunën si dhe të njëjtat nuk janë të evidentuara në regjistër të pasurive;
3. Sa i përket banesave nga "Ndërtesa e bardhë" për evidentim të tyre, është krijuar edhe një komision në vitin 2012. Nëse krahasojmë përdoruesit e evidentuar nga komisioni i vitit 2012 me regjistrin e evidentuar nga viti 2014, ekzistojnë mos përputhje të shfrytëzuesve, të identifikuar nga këto dy komisione;
4. Komisioni ka evidentuar gjithashtu mbi 200 njësi (banesa dhe lokale) të cilat kryesisht shfrytëzohen nga qytetarët, por nuk paguajnë ndaj komunës dhe kryesisht nuk kanë kontrata për shfrytëzim. Për më tej, vetëm 5 nga lokalet e evidentuara, janë të përfshira në databazën e qiradhënies komunale. Komuna pretendon se këto prona janë të saj, por ende nuk janë zgjedhur kontestet gjyqësore përfundimisht;

Konkluzionet e mësipërme janë pasqyrim i punës së komisionit të brendshëm komunal, të emëruar nga Kryetarja. Për nevoja të auditimit, ende nuk është marrë siguri për vlerën dhe pronësinë finale të këtyre pronave.

2.3 Pagesat sipas vendimeve gjyqësore

Çështje tjetër për vëmendje mbeten pagesat e shumta të ekzekutura sipas vendimeve gjyqësore dhe nenit 39.2 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP):

Çështja 1 - Pagesa sipas vendimeve gjyqësore dhe nenit 39.2 të LMFPP - Prioriteti i lartë

E gjetura Gjatë vitit 2015, në bazë të vendimeve gjyqësore dhe dispozitave të nenit 39.2 të LMFPP, Thesari ka ekzekutuar afërsisht 360,000€ nga buxheti komunal. Ngjashëm ishte edhe vitin e kaluar. Shkaku në lidhje me këtë, ka të bëjë me borxhet e mëdha të trashëguara që nga viti 2013 dhe mungesa e mjeteve financiare për të kompenzuar operatorët ekonomik (OE). Kjo ka bërë që një numër i projekteve kapitale të buxhetuara nuk janë përfunduar apo edhe nuk ka filluar zbatimi i procedurave të prokurimit.

Sipas zyrtarëve komunal, një pjesë e lëndëve të cilat datojnë para vitit 2008, të realizuara nga përmbaruesi privat dhe të dërguara për pagesë në Thesar, janë në kundërshtim me ligjin për faljen e borxheve (meqë disa obligime janë pretendime të ndërmarrjeve publike) si dhe ligjin për përmbarimet sipas së cilit lëndët duhet të kenë ndër të tjera raportin e pranimit të punëve nga organi mbikëqyrës. Komuna pohon se përmbaruesi fillon procedurën nëse ekziston kontrata pavarësisht raportit të pranimit për kryerjen e punëve.

Rreziku Fenomeni i ekzekutimit të pagesave nga Thesari ç'ekuilibron projeksionet buxhetore dhe rrezikon arritjen e objektivave si dhe realizimin e projekteve të planifikuara. Vënia në pikëpyetje e legjitimitetit të pagesave të ekzekutuara rrezikon dëmtim të buxhetit komunal apo humbje financiare.

Rekomandimi 2 Kryetarja duhet të siguroj se krijohet një strategji e përgjithshme për trajtimin e borxheve të mbetura, përfshirë buxhetimin e tyre. Rastet ku komuna konteston rregullësinë e pagesave nga përmbaruesit privat, të procesoj në instanca më të larta shqyrtimin e lëndëve.

2.4 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti i auditimit për vitin 2014 ka rezultuar në 16 rekomandime dhe është përgatitur në kohë, plani i veprimit për mënyrën e adresimit të tyre. Raporti i auditimit ishte diskutuar në Kuvendin Komunal, më datë 21.07.2015.

Deri në përfundimin e periudhës së auditimit 2015, gjithsej 2 rekomandime janë implementuar, 8 janë adresuar dhe janë proces të implementimit si dhe 6 nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Shtojcën III.

Çështja 2 - Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

- E gjetura** Vetëm dy rekomandime të vitit të kaluar janë implementuar dhe një pjesë janë trajtuar pjesërisht, meqë komuna nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e implementimit të rekomandimeve të AP, përfshirë edhe këshillat tona të dhëna në fazën nëntëmujore.
- Rreziku** Dobësitë e përsëritura në sistemet financiare kanë rezultuar në:
- çertifikim të parregullt të pagesave dhe keqklasifikime;
 - menaxhim të dobët të qiradhënies së pronave komunale; dhe
 - dobësi në sistemin e auditimit të brendshëm.
- Rekomandimi 3** Kryetarja duhet të sigurojë që plani i veprimit, zbatohet, rishikohet dhe i njëjti përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të dhëna nga AP, me stafin përgjegjës të emëruar për monitorim rigoroz të këtij procesi.

2.5 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave (MF) ka hartuar një listë të detajuar të vetëvlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Më poshtë, ne kemi përmbledhur gjetjet tona për komunën. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetëvlerësimit, por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për t'i mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 3 - Lista kontrolluese e vetëvlerësimit - Prioritet i lartë

E gjetura Ne kemi shqyrtuar disa pyetje kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit në lidhje me komponentat përkatëse dhe kemi vlerësuar se:

1. Procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut nuk janë vendosur dhe kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.6;
2. Komuna ende nuk ka të miratuar një plan strategjik për zhvillim ekonomik. Përkundër kësaj, komuna ka vlerësuar me notë të lartë pyetjen që ndërlidhet pikërisht me strategjinë dhe koston financiare respektive. Por, vlenë të përmendet, se në janar 2016, komuna ka inciuar përgatitjet për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Socio-Ekonomik. Në grupet punuese janë të përfshirë edhe akterë nga shoqëria civile. Drafti i parë pritët të dorëzohet në Kuvendin Komunal në maj 2016; dhe
3. Në lidhje me planifikimin dhe zbatimin e prokurimit, janë identifikuar shumë dobësi (referoju kapitullit 3.4) derisa përgjigja në vetëvlerësim ishte me notë të lartë. Madje edhe rekomandimet nga viti i kaluar janë përsëritur sa i përket prokurimit.

Konsiderojmë se komuna nuk ka qenë vetëkritike dhe mjaft objektive në plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit.

Rreziku Aranzhimet e dobëta të qeverisjes i dobësojnë proceset strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët. Vetëvlerësimi jo objektiv rrezikon që menaxhmenti të krijoj komoditet me rezultatet e arritura kur njëkohësisht situata faktike është ndryshe.

Rekomandimi 4 Kryetarja duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe në mënyrë proaktive të bëhet adresimi i fushave me dobësi të identifikuara. Duhet të aplikohet një mekanizëm rishikues për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës për përgjigjet e konfirmuara.

2.6 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar në planifikimin e auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit komuna operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.6.1 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara në procedurat e MFK-së kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar, për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik.

Çështja 4 – Mos zbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut – Prioriteti i mesëm

- E gjetura** Në pyetësor është rikonfirmuar se komuna ka identifikuar rreziqet të cilat do të kanosnin arritjen e objektivave dhe reagimet në rast të ndodhjes së tyre. Por nuk ekzistojnë dokumentacione mbështetëse (dokument i rreziqeve të identifikuara) për të konfirmuar këtë pohim.
- Rreziku** Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëlojë cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve pasi çështjet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në këtë, nuk adresohen në kohën e duhur. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla, nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.
- Rekomandimi 5** Kryetarja duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive do të menaxhojë këtë proces dhe do të raportojë në baza të rregullta mbi rreziqet.

2.7 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) në komunë funksionon me vetëm një auditor, dhe atë drejtorin e kësaj njësie. Ne kemi vërejtur një numër mangësish në këtë sistem.

Çështja 5 - Mangësi në planifikimin dhe funksionimin e auditimit e brendshëm (AB) - Prioriteti i lartë

E gjetura

Për vitin 2015 janë planifikuar pesë auditime, prej të cilave dy kishin zënë vend në planin e auditimit si auditime të veçanta në rast kërkesë nga Kryetarja. Plani për tre auditimet tjera kishin të bëjnë me Shpenzimet në zyrën e komuniteteve, Të hyrat në urbanizëm si dhe Menaxhimi i pasurisë. Në mars 2015 AB ka raportuar për shpenzimet në Drejtorinë e Shëndetësisë (raport ky që fushëveprim kishte vitin 2013) si dhe janë përfunduar raportet: Shpenzimet në zyrën e komuniteteve, Të hyrat në Urbanizëm si dhe Menaxhimi i pasurive;

Gjatë vitit 2015 NjAB ka operuar në përbërje prej vetëm një auditori. Përbërja e kapaciteteve të NjAB, me vetëm një auditor, nuk është e mjaftueshme dhe jo në përputhje me UA 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e NjAB-ve. Udhëzimi përcakton, që për komunat me një buxhet mbi 5,000,000€ mund të angazhojnë numër më të madh auditorësh të brendshëm, po që se kjo vlerësohet e nevojshme;

Komuna nuk ka themeluar Komitetin e Auditimit të Brendshëm i cili do ndihmonte dhe përmirësonte funksionimin e këtij sistemi;

Edhe pse ndryshojnë objektivat e NjAB-së dhe auditimit të jashtëm, duhej të ekzistonte mundësia për bashkëpunim/mbështetje në punën e NjAB nga auditorët e jashtëm. Sidoqoftë, objektivat, qasja e testimit dhe mbulueshmëria e auditimit nga NjAB nuk janë në përputhje me kërkesat e auditimit të jashtëm dhe nuk adresojnë të gjitha fushat me rrezik domethënës;

Rreziku

Mos funksionimi adekuat i njësisë së auditimit zvogëlon sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me funksionimin e sistemeve të brendshme. Kjo mund të rezultojë me dobësi të paidentifikuara dhe me vazhdimin e praktikave joefektive. Gjithashtu, mungesa e numrit të mjaftueshëm të auditorëve bën që raportet të mos i nënshtrohen asnjë kontrolli apo rishikimi të cilësisë.

Rekomandimi 6

Kryetarja duhet të sigurojë se sistemi i auditimit të brendshëm bëhet funksional dhe përfitimet maksimale merren nga shërbimet e sigurisë të ofruara nga AB. Më tej, të sigurohet se përbërja e kapaciteteve njerëzore si në njësinë e auditimit, ashtu edhe në Komitetin e Auditimit, është në përputhje me rregullat për funksionimin e sistemit të AB.

Çështja 6 - Vonesa në konsolidimin e NjAB-së - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Me përfundimin e vitit 2015, ka filluar pensionimi i të vetmit auditor të brendshëm. Deri në prill 2016, ende nuk ishte bërë rekrutimi i auditorëve të rinj, dhe NjAB ishte tërësisht jofunksional. Ne vlerësojmë që komuna nuk ka qenë mjaft e përkushtuar në konsolidimin e kësaj zyre. Sipas komunës, procesi ka stagnuar tek aprovimi nga MF dhe asaj për Administratë Publike, për të lejuar publikimin e pozitave të lira.
- Rreziku** Mungesa e sistemit të auditimit të brendshëm rrezikon që kontrollet e brendshme të mos rishikohen për të mundësuar përmirësimin e tyre, aty ku mangësitë mund të jenë të pranishme.
- Rekomandimi 7** Kryetarja duhet të sigurojë që janë zbatuar veprime të mjaftueshme në raport me nivelin qëndror, për të mundësuar konsolidimin e NjAB. Në një proces transparent rekrutues, sugjerojmë të jetë përfshirë edhe Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm e MF.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për MFK, jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore, si dhe pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Për komunën, menaxhimi i pasurive së bashku me qiradhëniet, prokurimi, monitorimi i subvencioneve dhe auditimi i brendshëm mbeten fusha më shqetësuese. Në kontekst të sistemeve financiare, duhet të shtohen kontrollet mbi çertifikimin e pagesave dhe klasifikimin e tyre. Parregullësitë më të mëdha janë evidentuar në muajt e fundit të vitit.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – shpenzimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2015 Shpenzimi	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi
Burimet e Fondeve:	20,268,994	21,413,969	20,104,201	19,429,426	18,783,539
Granti i Qeverisë -Buxheti	17,242,683	17,694,209	17,635,086	16,755,270	16,254,860
Të bartura nga viti paraprak ²		384,494	348,833	296,632	333,255
Të hyrat vetjake ³	3,026,311	3,026,311	2,002,422	2,348,116	2,074,262
Donacionet e brendshme		153,820	17,218	13,372	110,646
Donacionet e jashtme		155,135	100,642	16,036	10,516

Buxheti final tejkalon buxhetin fillestar për 1,144,975€. Kjo është si rezultat i rritjes së Grantit Qeveritar prej 451,526€ për të mbuluar kompensimin e përvojës, donacioneve vendore dhe të jashtme prej 308,955€ si dhe të hyrave të bartura, në total prej 384,494€.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të pashpenzuara të komunës në vitin paraprak dhe të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Ngjashëm me vitin e kaluar, në vitin 2015, është shpenzuar 94% e buxhetit final. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale dhe shpenzimin e fondeve.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - shpenzimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Shpenzimi	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	20,268,994	21,413,969	20,104,201	19,429,426	18,783,539
Pagat dhe Mëditjet	12,400,000	12,841,887	12,834,526	11,759,147	10,149,794
Mallrat dhe Shërbimet	1,478,000	1,641,965	1,561,945	1,404,276	1,522,469
Shërbimet komunale	604,499	569,081	556,077	716,377	650,300
Subvencionet dhe Transferet	535,202	754,147	660,160	509,556	457,649
Investimet Kapitale	5,251,293	5,606,889	4,491,493	5,040,070	6,003,327

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Komuna ka realizuar 80% të investimeve kapitale e cila paraqet një rënie në krahasim me vitin e kaluar për 11%; Në këtë realizim përfshihen pagesat për vendimet gjyqësore të projekteve kapitale të cilat jo domodoshmërisht ndërliken me projekte të vitit aktual, në vlerë 339,084€. Mos inkasimi i të hyrave vetjake ishte shkak i realizimit të ulët tek investimeve kapitale.;
- Sfidë mbetet ende përdorimi i të hyrave vetjake për investime kapitale. Nëse krahasojmë buxhetin fillestar të planifikuar (2,232,109€), shpenzimet e të hyrave vetjake për investime kapitale, ishin 1,434,206€ apo në shkallë 64%;
- Buxheti i donacioneve të brendshme kryesisht po bartet vit pas viti dhe ka të bëjë me një projekt për të cilën kanë participuar qytetarët (afro 140,000€), por për të cilin mjetet nga bashkëfinancimi i komunës nuk janë buxhetuar asnjëherë dhe daton që nga viti 2013. As në vitin 2015, mjetet ende nuk ishin buxhetuar nga komuna. Nga komplet kapaciteti i shpenzimit të të hyrave vetjake prej 2,965,703€ (Inkasimi aktual si dhe të barturat nga viti 2014), rreth 21% apo 614,448€ janë bartur për shpenzim në vitin vijues. Kjo paraqet një shkallë të volitshme të bartjes duke marrë parasysh që të hyrat e mbledhura në tremujorin e fundit në vlerë rreth 570,000€ mund të mos shpenzohen, meqë mbyllet viti fiskal;

Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e komunës - pranimet kundrejt buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Pranimet	2014 Pranimet	2013 Pranimet
Të hyrat vetjake	3,026,311	3,026,311	2,581,209	2,731,645	2,370,064

Çështja 7 - Rënie e realizimit të të hyrave vetjake - Prioriteti i Lartë

- E gjetura** Gjatë vitit 2015, plani i të hyrave u realizua për 85%, nivel ky më i ulët për 5% se në vitin paraprak (rreth 90%). Kjo është ndikuar nga rënia e inkasimit të tatimit në pronë, si e hyrë dominuese në të hyrat komunale. Inkasimi i tatimit në pronë arriti vlerën 1,165,236€ dhe paraqet një rënie prej 99,523€ krahasuar me vitin e kaluar.
- Rreziku** Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe realizimi i ulët i tij do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe në financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm.
- Rekomandimi 8** Kryetarja duhet të sigurojë që performanca buxhetore monitorohet në mënyrë sistematike dhe të ndërmerren masat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar.

3.4 Prokurimi

Rregullat e Prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe të ekzekutimit e tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit.

Ne kemi hasur në një numër mangësish në këtë fushë:

Çështja 8 - Dobësi sistematike në prokurim - Prioritet i lartë

- E gjetura** Ekziston një dukuri e zbatimit të vazhdueshëm të llojit të procedurave me kuotim çmimesh dhe vlera minimale. Prej 187 procedurave të kryera në prokurim, në 116 procedura apo 62%, janë përdorur procedura kuotimi dhe atyre me vlerë minimale, në vend që të shkohet me procedura të hapura. Kjo ka shpjer edhe në ndarje të tenderëve ku për produkte dhe shërbime të natyrës së njëjtë, janë zbatuar një numër i madh i procedurave, si:
- Për kompjuter, laptop, printer, fotokopje dhe pajisje tjera janë zbatuar tre procedura kuotimi dhe shtatë minimale. Në këto procedura minimale për katër produkte janë përdorur brende si Canon, Lenovo dhe HP. Në njërën nga këto procedura kuotimi, është kërkuar aparat fotokopjues i përdorur, i cili ishte ofertuar me çmim 900€.
-

Gjatë rishikimit të procedurave dhe ekzaminimit fizik tek projekti "Renovimi i katit të dytë në QKMF" vërejtëm mangësitë si vijon:

- Ky renovim fillimisht ishte kontraktuar nga një Operator Ekonomik (OE) në shumën 47,523€ më 08.09.2014 me të cilin kishin probleme në realizim të projektit për shkak të mos kryerjes së punimeve nga ana e OE. Komuna ka bërë marrëveshje me OE për ndërprerje të punimeve dhe që t'i bëhet pagesa në vlerë të situacionit 6,976€; Për njëtin projekt, më 01.07.2015 u kontraktua operatori i dytë fitues, në vlerë 59,127€, të cilit i janë bërë pagesa gjithsej 59,023€;
- Gjatë ekzaminimit fizik konstatuam se operatori i parë ishte paguar për pozicionet e më poshtme, për deri sa punët nuk ishin përfunduar. Po ashtu, këto pozicione nuk shihen as në ditarin e punës. Kjo ka të bëjë me: pozicionin e vendosjes së perdeve të dritareve 4,140€, dhe për pozicionin "punët e zdrukthëtarisë metalike" 769€;
- Operatori i dytë është paguar për vendosjen e dy radiatorëve në vlerë 300€ por ne kemi vërtetuar që puna nuk është kryer. As në ditarët e punës nuk evidentohet një gjë e tillë;
- Është lidhur aneks kontratë në vlerë 5,870€, për disa pozicione të cilat nuk ishin pjesë e kontratës bazë. Tek njëri nga këto pozicione (ndërtimi i shtëpizës së bonbolave) ndërtimi ishte bërë në madhësinë 2.25x2.15 derisa në situacionin për pagesë ishte 2.5x2.5 në vlerë 800€;
- Për të gjitha këto parregullsi të hasura nga ne gjatë ekzaminimit fizik është pajtuar edhe menaxheri i projektit.
- Për punimet e instalimit të elektrikes, operatori i dytë është paguar dy herë nga 130€ për pozicionet e njëjta;
- Në dosjen e tenderit (paramasa dhe parallogaria) ishte cekur emri i prodhuesve në tre pozicione të kërkuara si dhe OE nuk kishte ofertuar në një pozicion të dosjes së tenderit;
- Kishte vonesa në realizim të këtij projektit. Projekti parashihej të përfundoj për 70 ditë pune, derisa edhe pas 10 muajsh ende nuk janë përfunduar punimet;

Komuna nënshkroi kontratë publike kornizë për “Rrënimin e objekteve të ngritura pa leje, ndërtime ilegale dhe shërbime tjera” ku sasia e vlerësuar (indikative) për periudhën 02.07.2015 - 02.07.2017 ishte gjithsej 12,993€. Nga katër pagesa të testuara, kemi vërejtur se komuna kishte paguar shumën 34,999€ që është në kundërshtim me UA 2/2015 neni 5.1 ku ceket se autoriteti kontraktues do të specifikoj në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo tavan dhe lejohet devijim jo më i lartë së plus/minus 30%. Gjithashtu neni 5.2 specifikon se nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë indikative, pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit, kontrata duhet të ndërpritet automatikisht;

Në tre raste, siguria e ekzekutimit të kontratës, nuk ishte në shumën 10% të vlerës së kontratës, siç kërkohet me nenin 63 të LPP. Komuna kërkonte sigurinë vetëm deri në vlerën e zotimit të vitit aktual;

Tek kontrata “Ndërtimi-Asfaltimi i rrugës Fehmi Agani” OE fitues nuk kishte dërguar vërtetim nga administrata tatimore që nuk është në vonesa me pagesën e tatimeve se paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit. Gjithashtu, vërtetimin nga gjykata e kishte dërguar kopje jo të noterizuar, ndërsa kërkesa e dosjes së tenderit ishte origjinali ose kopje e noterizuar.

Rreziku

Këto raste tregojnë për dobësi serioze dhe të vazhdueshme në prokurim, të cilat kanë shkaktuar humbje financiare për komunën. Prania e dukurive të tilla gjatë planifikimit dhe përzgjedhjes së llojit të procedurave dëmtojnë transparencën, eliminojnë konkurrencën dhe vejnë në pikëpyetje cilësinë e shërbimeve/produkteve të pranuar dhe përmbushjen e projekteve. Paramasat jo korrekte sjellin shpenzime shtesë dhe vonesa në realizim.

Rekomandimi 9

Kryetarja duhet të kërkojë përgjegjësi nga personat që kanë lejuar lëshimet dhe humbjet e mësipërme financiare. Zyra e prokurimit duhet të shtoj kujdes në përcaktimin e pozicioneve, dhe gabimet e tilla të mos përsëriten. Një planifikim i hollësishëm është i nevojshëm dhe njësitë duhet të vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat për prokurim.

Çështja 9 - Dobësitë jo sistematike në prokurim – Prioritet i mesëm

E gjetura

Në kontratën e nënshkruar, për ngritjen e kapaciteteve të stafit mjekësor për të zbatuar “Strategjinë e standardit të rritjes tek fëmijët 0-5 vjeç”, me plan kryerje prej tre ditësh, ne kemi vërejtur mangësitë në specifika, dhe atë si vijon:

- I gjithë projekti për trajnimin e stafit shëndetësor është ofertuar me çmim 9,676€ dhe pagesa është kryer në tërësi sipas raportit të komisionit për pranimin e shërbimeve. Por, ky raport ishte bërë para kryerjes së trajnimeve me ç’rast edhe pagesa është kryer pa u pranuar ky shërbim. Trajnimi i pjesëmarrësve ka filluar nga muajin shkurt 2016, derisa pagesa ishte kryer në tërësi në dhjetor 2015. Deri në Prill 2016 janë trajnuar gjithsej 193 persona derisa me specifika parashihej trajnimi i 215 pjesëmarrësve;
- Specifikat e këtij tenderi nuk ishin në përputhje me parimet e ekonomizimit të shpenzimeve dhe natyrës së projektit. Komuna ka vendosur në specifikacion blerjen e fletoreve, lapsave, fletave të bardha, markerave etj, edhe pse për të njëjtat furnizime ka kontratë me operatorë tjerë. Me këtë rast, vetëm për një copë kuti fleta të bardha (prej 500 copë) janë paguar afro 16€ apo 0.03 cent për fletë të bardhë. Në specifikë ishte vendosur pozicioni për 2,100 fleta të bardha;
- Për derivate, komuna kishte kërkuar 200 litra si pozicion. Gjithashtu, janë specifikuar edhe shpenzimet komunalie si rrymë, ujë, mbeturina dhe mirëmbajtje;
- Kompenzimi i koordinatorit është ofertuar në vlerë prej 3,000€;
- Shpenzime të paparashikuara janë kërkuar dhe i njëjti pozicion është ofertuar në vlerë rreth 10% të kontratës apo 945€;
- Të gjashtë pikat e mësipërme kanë të bëjnë me projektin “Strategjia e standardit të rritjes tek fëmijët 0-5 vjeç”.

Gjatë realizimit të projektit “Ndërtimi-Asfaltimi i rrugës Fehmi Agani” (198,119€), Zyra e prokurimit dhe mbikëqyrësit e projektit kishin aprovuar kërkesën e OE për ndërrim të pozicionit të gypave nga beton arme në gypa Φ400 mm të brinjëzuar, kërkesë për të cilën nuk ka dëshmi se është aprovuar nga ZKA. Prokurimi kishte kërkuar nga tre OE, oferta për këtë pozicion (1 m’ Gyp Φ400), e cila u fitua nga i njëjti OE që e kishte kontratën bazë. Edhe këtu në specifika nuk ishte caktuar sasia e përafërt. Pagesa e situacionit të parë (04.12.2015) ka përfshirë tetë pozicione të gypave të njëjtë sipas kontratës bazë, por të cilat në bazë të aprovimit nga Zyra e prokurimit, do duhej të ndryshohen. Gjatë rishikimit të ditarit të punimeve të projektit kemi identifikuar se gypat për të cilat ka paguar komuna nuk janë ekzekutuar në terren, mirëpo janë ekzekutuar gypa Φ 400 mm të brinjëzuar. Ndryshimet e tilla të kontratës janë në kundërshtim më Udhëzuesin Operativ të Prokurimit i cili cekë së ndryshimi i kontratës se pozicione shtesë të artikujve të njëjtë duhet të behët me çmime të njëjta apo me të ulëta për njësi si në kontratën fillestare.

Në projektin “Shtruarja e rrugëve, trotuareve dhe sipërfaqeve tjera me kubëza betoni” (kontratë publike kornizë), identifikua që komuna nuk ka parashikuar sasinë e përafërt, siç kërkohet me nenin 26, pika 1 dhe 2, të rregullores për prokurimin publik;

Komuna ka bërë vazhdimin e kontratës kornizë “Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe hapësirave urbane dhe shtratit të lumit Krena “ në kundërshtim më nenin 38, paragrafi 2 të LPP sipas së cilit kontratat kornizë nuk mund të ripërtërihen. Vazhdimi ishte bërë në formë të aneksit, dhe atë për disa muaj pas skadimit të kontratës bazë. Për lëshime të njëjta, është raportuar edhe në vitin e kaluar;

Për projektin “Furnizim me makina mjelëse” në vlerë të parashikuar 30,000€ i njëjti nuk ishte planifikuar në planin e prokurimit. Me rastin e nënshkrimit të disponueshmërisë së mjeteve, ky projekt nuk është dërguar në AQP.

Rreziku

Gjetjet e mësipërme tregojnë për dështime të komisioneve pranuese dhe personave mbikëqyrës me rastin e kompletimit të lëndës për pagesë, duke rrezikuar ekonomizimin e shpenzimeve dhe pranimin e shërbimeve krahas parasë së dhënë. Opinioni i auditimit mund të ndikohet nga pagesa të tilla. Më tej, ndryshimet e pozicioneve të kontratës, rrisin rrezikun që komuna të furnizohet më produkte të cilat janë më të larta se sa çmimet në treg në mungesë të procedurave të hapura të prokurimit.

Rekomandimi 10

Kryetarja të shqyrtoj arsyet pse kërkesat e rregulloreve të prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë në rastet e mësipërme, si dhe të forcoj masat e kontrollit që dështimet e tilla të mos përsëriten. Në rastin e trajnimit të stafit shëndetësor në të ardhmen, Kryetarja të shqyrtojë mundësitë e trajnimit nga vet pjesa e stafit. Punimet të mbikëqyren në vazhdimësi dhe pagesat të bëhen vetëm pasi merret siguri se pozicionet janë realizuar si dhe mangësitë e tjera në procesin e prokurimi të mos përsëriten.

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

3.5.1 Shpenzime tjera

Çështja 10 – Monitorim i dobët i projekteve strategjike – Prioriteti i lartë

E gjetura Vitin e kaluar është raportuar për marrëveshjen (lidhur në gusht 2014) mes komunës dhe OJQ European Kosova, për realizimin e konkursit urbanistik arkitektonik në vlerë 60,000€ (kësti i parë 30,000€ në vitin 2014 dhe 30,000 në vitin 2015) për hartimin e projekteve ideore, konkurs ky i nivelit evropian. Edhe pse vitin e kaluar është raportuar për pagesën e kështit të parë, pa raport të punimeve të kryera, dobësi në këtë lëndë kishte edhe këtë vit. Sa i përket raporteve narrative, European ka raportuar për aktivitetet e kryera si dhe Kryetarja dhe Drejtorja e Urbanizmit ishin direkt të përfshira në mbarëvajtjen e këtij projekti. Por, shuma 60,000€ e ndarë ndaj European Kosova, ishte e bazuar në një buxhet të përpiluar nga OJQ. Komuna nuk kishte siguri nëse këto mjete janë shpenzuar sipas qëllimit dhe nëse kostot kanë ndodhur me të vërtetë. Kështu, mungojnë dëshmi financiare dhe faturat përkatëse. Përveç kësaj, në buxhetin prej 60,000€ përfshiheshin edhe shpenzime si qiraja e zyrës dhe shpenzime komunale për 24 muaj, dy lloje antarësish, që konsiderojmë, jo domosdoshmërisht se duhet të mbulohen nga komuna.

Memorandumi i datës 27.03.2015 i lidhur mes Qendrës Kosovare për Zhvillim “KDC” dhe komunës parasheh restaurimin e objektit për funksionimin e qendrës multifunkionale të bizneseve në Gjakovë. Për këtë projekt komuna participon në vlerë 34,731€ ndërsa “KDC” në bazë të një njoftimi (30.03.2015) participon shumën 39,989€. Pagesa për participimin nga komuna ishte bërë nga kategoria e investimeve kapitale (datë 23.04.2015), pa ndonjë dëshmi për pranimin e punëve apo shërbimeve. Gjatë fazës së auditimit final, kemi pranuar raportin për kryerjen e punimeve të datës 25.05.2015, do të thotë pas ekzekutimit të pagesës.

Rreziku Pagesat për bashkëfinacuesit, pa mbështetje në raporte konkrete të realizimit të punëve dhe në mungesë mbikëqyrjeje, mund të rezultojë në mos përmbushjen e obligimeve nga palët, vlerë të dobët për paranë e dhënë dhe pagesa të parregullta. Më tej, një pjesë e tyre nënkupton para të dhënë avans dhe mund të ndikojë opinionin e auditimit.

Rekomandimi 11 Kryetarja duhet të sigurojë se ndërmerren masa në mbikëqyrjen e marrëveshjeve me bashkëfinancim përfshirë kërkesat të qarta të raportimit gjatë implementimit dhe monitorimit të projektit, në pajtim me kërkesat e marrëveshjeve si dhe rregullave për shpenzimin e parasë publike. Rasti me EUROPEAN duhet të monitorohet në veçanti në kontekst të konfirmimit të dëshmive financiare. Dhe, në rastin e marrëveshjeve të reja, të aplikohen kontrolle të shtuara që asnjë pagesë të mos bëhet para se punët apo shërbimet të jenë kryer.

Çështja 11 – Tejkallim i shpenzimeve të telefonisë mobile dhe parregullësi në shpenzimet për reprezentacion – Prioritet i mesëm

E gjetura Mostra e shpenzimeve të telefonisë mobile e cila ka përfshirë muajt shkurt, mars dhe prill 2015, ka treguar që tre zyrtarë komunal kanë shpenzuar përtej limiteve të caktuara me udhëzim të brendshëm, dhe atë: Kryetari i Kuvendit ka shpenzuar për tre muaj gjithsej 241€, Drejtori i Teatrit gjithsej 232€ si dhe Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik e cila ka shpenzuar 60€ për muajin Shkurt. Sipas udhëzimit intern, Kryesuesi dhe Drejtorët kanë të lejuar 50€ shpenzime për muaj. Komuna nuk u ka kërkuar zyrtarëve mbulimin e këtyre mbi shpenzimeve.

Për pjesëmarrësit e festivalit Komedia Fest (mbajtur prej 06-13 Shtator 2014), komuna pagoi nga buxheti i Drejtorisë së Kulturës vlerën 12,220€, për fjetje dhe akomodim të rreth 125 pjesëmarrësve në këtë festival. Përveç që nuk janë zbatuar procese prokurimi, Drejtoria e Kulturës ka hyrë në obligime për këtë shpenzim pa vendim paraprak, pa zotim të mjeteve si dhe nuk ka kompletuar lëndën sipas rregullave për pagesë.

Rreziku Shpenzimet e pajustificueshme operative dhe monitorimi i dobët i këtyre shpenzimeve, dëmton buxhetin komunal derisa pagesat e tilla për reprezentacion të pa mbuluar me dokumente mbështetëse, dëmton transparencën dhe lë hapësirë për shfrytëzim jo efikas të parave publike dhe keqpërdorim.

Rekomandimi 12 Kryetarja duhet të sigurojë se në rast të çdo tejkallimi të limiteve të telefonisë mobile, shpenzimet paguhen nga pagat e zyrtarëve përkatës si dhe të bëhet një rishikim i të gjitha shpenzimeve për vitin 2015 ku çdo mbi shpenzim t'i kthehet buxhetit të Kosovës, nga zyrtarët të cilët kanë shpenzuar në mënyrë të pajustificueshme këto mjete. Më tej, për rastin e dytë duhet siguruar se shtohen kontrollet e duhura në shpenzimet e reprezentacionit, në mënyrë që dobësitë e njëjta të mos përsëriten.

3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave janë listat e pagave të nënshkruara nga udhëheqësit e njësive. Në përgjithësi ekzistojnë kontrole në këtë fushë, megjithatë ne kemi hasur mangësitë si vijon:

Çështja 12 - Mangësi në procedura rekrutimi dhe pagesa të kujdestarive - Prioriteti i mesëm

E gjetura Për pozitën "zyrtar për promovimin e investimeve", shpallur më 26.05.2015, ishte shkelur neni 29.1 të rregullores për rekrutim sipas së cilës, nëse paneli nuk mund të identifikojë së paku tre kandidatë adekuat për përfshirje në listën e shkurtër, pozita duhet të rishpallet. Në këtë proces asnjë kandidat nuk i kishte plotësuar kriteret (përvojën e punës) duke përfshirë edhe kandidatin e përzgjedhur, ndërsa komuna nuk e kishte rishpallur këtë pozitë.

Sipas kërkesës për veprim të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë me datë 17.07.2013, fondi i orëve i obliguar për një të punësuar është 174 orë/muaj. Gjatë rishikimit të kujdestarive, kemi vërejtur se kalkulimet për pagesën e orëve shtesë janë bërë duke u bazuar në fond më të vogël të orëve përkatësisht në 160 orë në muaj. Si rrjedhojë, në vitin 2015 rreth 4,000€ janë paguar me shumë për mesatarisht 50 persona/muaj.

Rreziku Prania e parregullësive në procesin e rekrutimit mund të rezultojnë në konkurrencë të padrejtë si dhe mos punësim të personelit adekuat. Pagesa e pasaktë e kujdestarive rrezikon dëmtimin e mëtejshëm të buxhetit komunal.

Rekomandimi 13 Kryetarja duhet të siguroj që rekrutimet e kandidatëve bëhen në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Për rastin e kujdestarive në shëndetësi, të siguroj se zyrtarët e pagesave i zbatojnë kërkesat e rregulloreve dhe nuk do të certifikojnë pagesat nëse kushtet nuk janë plotësuar.

3.5.3 Subvencionet dhe Transferet

Komuna planifikoi 754,147€ për Subvencione dhe Transfere (S&T), ndërsa shpenzoi 660,160€ apo 87% të planit. Shpenzimet kryesisht kanë të bëjnë me mbështetje të fermerëve, aktiviteteve kulturore, mbështetje financiare për biznese të vogla, ndihma momentale dhe bursa studentore. Testimet tona kanë treguar për një numër mangësish sa i përket procesit të arsyeshmërisë së subvencioneve, dhe atë si vijon:

Çështja 13 – Dobësi në menaxhimin e subvencionieve – Prioriteti i mesëm

E gjetura Kuvendi Komunal lejoi subvencionimin e Ngrohtores në vlerë 156,851€ për aktivizimin e ngrohtores për sezonin 2015-2016. Qëllimi ishte të zhbllokohen llogaritë bankare të Kompanisë për shkak të obligimeve financiare, të investohej në kalldaj dhe rrjet primar të termofikimit, kryerjen e obligimeve për licensat ndaj Zyrës Regjionale për Energji si dhe pagesa e punonjësve për vitin 2014 dhe pjesërisht për vitin 2015. Këto mjete janë rialokuar nga disa projekte kapitale. Komuna nuk ka pranuar raporte kthyesë për të vlerësuar nëse mjetet janë shpërndarë sipas planit.

Sipas vendimit të bordit të drejtorëve, me rastin e subvencionimit të bletarëve me centrifuga gjysmë automatike në vlerë 10,000€, komuna nuk zbatoi procedurat e prokurimit për blerjen e këtyre pajisjeve. Në vend që ta implementoj vet procesin, komuna shpalli ftesë për projekt propozime nga shoqatat bujqësore apo të bletarëve. Nga tre oferta u zgjodh OJQ Flora e cila ka bërë blerjen e centrifugave.

Komuna përfitoi nga Qeveria Britaneze donacionin në vlerë rreth 32,409€ prej të cilave shuma 5,587€ do të paguhej nga komuna, për themelimin dhe zhvillimit të Zyrës për Këshillim dhe Zhvillim të Biznesve, me qëllim të përkrahjes së bizneseve të reja. Aktivitetet kishin të bëjnë kryesisht me trajnime dhe këshillime si dhe krijimin e një web faqeje me informata për nxitje të ekonomisë. Për implementim të projektit, komuna angazhoi OJQ Qendra Inovative Gjakovë, përmes një marrëveshjeje bashkëpunimi me të. Për shumën e paguar nga fondet e komunës, ne kemi vërejtur se:

- Janë paguar rreth 1,300€ për shpenzime komunale ndaj Qendrës Inovative (telefon, mbeturina, rrymë, kycje në ujësjellës dhe kanalizim, etj) pavarësisht që në buxhetin e projektit theksohet që komuna do të mbulojë vetëm shpenzimet për broshura, fletore dhe material të shtypur;
- Në pagesat për shpenzimet e nëntorit dhe dhjetorit, janë të pranuar vetëm kopje të faturave në vlerë gjithsej 2,803€.

Rreziku Gjetjet më lartë tregojnë për mangësi në aplikimin e kontrolleve në implementimin e projekteve dhe kryerjen e pagesave. Kjo rrit rrezikun që fondet në dispozicion të mos shpenzohen në pajtim me qëllimet fillestare të marrëveshjes. Anashkalimi i procedurave të prokurimit dhe delegimi i përgjegjësive tek OJQ, për aktivitetet të cilat komuna është përgjegjëse, rrezikon që vlerë e dobët të merret në këmbim të parasë së dhënë.

Rekomandimi 14 Komuna duhet të ndalojë fenomenin e pagesës së shpenzimeve operative të përfituesve të ndryshëm, derisa lënda për pagesë të ketë dokumentacionin relevant. Rasti i ngrohtores të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme. Më tej, procedurat e prokurimit të mos anashkolehen në asnjë rast ku ato mund të jenë të zbatueshme

3.6 Të hyrat

Këtë vit inkasimi i të hyrave vetjake ishte 2,581,209€ apo 150,436€ më i ulët se viti paraparak. Tatimi në pronë si kategori dominuese e të hyrave vetjake ka shënuar rënie krahasuar me vitin e kaluar (shih çështjen më poshtë) por komuna e arsyetonte këtë rënie me vendimin e Qeverisë për faljen e borxheve, me ç'rast qytetarët kanë filluar të tregojnë një lloj rezistence ndaj pagesës së tatimit në pronë. Mangësitë në këtë kategori ishin:

Çështja 14 – Planifikim jo adekuat i të hyrave vetjake – Prioritet i mesëm

E gjetura Me rastin e planifikimit të të hyrave, komuna nuk bën një vlerësim të përshtatshëm të kapaciteteve inkasuese dhe trendëve të viteve të kaluara të të hyrave, së këndejmi është vërejtur një planifikim jo ambicioz i të hyrave vetjake. Plani për 2014 ishte 3,045,000€ derisa këtë vit u planifikuan 3,026,311€, do të thotë 18,689 më pak. Gjithashtu nëse krahasojmë planin për zëra individual të të hyrave, vërehet që në disa raste janë bërë plane për inkasim shumë më pak se sa realizueshmëria e vitit paraparak si dhe ka raste kur planifikimi për zëra ishte aq i pa bazuar sa që realizimi i të hyrave nuk arrinte as shkallën 30%.

Në planin për tatimin në pronë propozuar nga menaxheri i tatimit në pronë, kemi vërejtur se nuk është përfshirë verifikimi i 1/3 së territorit për rivlerësim të pronave, siç kërkohet me UA 03/2011 për mbledhjen dhe regjistrimin e informatave të tatimit në pronë

Rreziku Planifikimi linear, pa mbështetje në analiza të trendeve dominuese, ekonomike si dhe potencialit në bazë të njësisë dhe popullatës, paraqet bazë për planifikim të dobët të buxhetit. Mos verifikimi i objekteve mund të shkaktoj humbje financiare për komunën.

Rekomandimi 15 Kryetarja duhet të sigurojë se me rastin e rishikimit të buxhetit bëhet përshtatje e planifikimit të të hyrave, bazuar në trendin e inkasimit të periudhave të mëparshme dhe kompleksitetin e operacioneve ekzistuese. Gjithashtu, burime të mjaftueshme të vihen në dispozicion për verifikimin e pronave të tatimpaguesve.

3.7 Pasuritë dhe detyrimet

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Krahasuar me vitin paraprak, është bërë progres në regjistrimin e pasurive në SIMFK, ku pasuritë në vijim si dhe blerjet aktuale janë procesuar në regjistrat kontabël. Vlera e tërësishme e pasurisë shënon 45,269,214€. Megjithatë, mbetet sfidë adresimi i të gjitha rekomandimeve nga raporti i auditimit. Gjetjet janë si vijon:

Çështja 15 – Regjistra jo të plotë të pasurive komunale - Prioritet i lartë

E gjetura Përkundër punës së bërë në verifikimin e pronave komunale, akoma nuk janë regjistruar të gjitha në regjistrat kontabël të pasurisë;

Sipas rregullores për menaxhimin e pasurisë nr.02/2013 të gjitha pasuritë e pranuar në pronësi pa marr parasysh a janë paguar, duhet të regjistrohen në regjistrat kontabël të pasurisë. Gjatë vitit 2015, pasuritë janë regjistruar vetëm pas realizimit të pagesave;

Për projektin me bashkëfinancim “Restaurimi i qendrës multi funksionale të bizneseve në Gjakovë”, në maj të vitit 2015 ishte pranuar dokument i transferit të pronësisë së objektit në komunë. Vlera e kësaj pasurie sipas raportit ishte 62,970€, ndërsa në regjistra të pasurisë është bërë regjistrimi vetëm i pjesës së paguar nga komuna dhe atë 34,731€. Kjo ka ndodhur shkak i mos kompletimit të të dhënave të nevojshme (specifikacioni i punëve të pranuar) për regjistrim të pasurisë;

Vlera e pasurisë nën 1,000€ e paraqitur në PVF nuk është e besueshme. Përveç që është paraqitur një vlerë simbolike (379,000€), për sektorin e arsimit dhe shëndetësisë përdoren regjistra të brendshëm të evidentimit, e jo E-pasuria si sistem i integruar qeveritar. Kjo ka bërë që me rastin e konsolidimit të të dhënave të ofrohen informata çorientuese për vlerën e tyre në libra sidomos nëse krahasojmë me vitin e kaluar (1,800,000€) të paraqitur në PVF 2014. Vlera e pasurive të Administratës Komunale e regjistruar në E-pasuri është 132,320€.

Rreziku Mos regjistrimi i plotë i pronave komunale, rritë rrezikun e nënvlerësimit të pasurive dhe shpalosjes së pasaktë të tyre. Në mungesë të evidencave të duhura, pasuritë mund t'i ekspozohen humbjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të tyre të pa autorizuar.

Rekomandimi 16 Kryetarja duhet të sigurojë se procesi gjithëpërfshirës i regjistrimit të pasurive do të vazhdoj dhe brenda një afati optimal do të nxirret një regjistër përfundimtar mbi pasuritë e komunës. Zyrtari për menaxhim të pasurisë dhe zyrtarët e angazhuar në pranimin e mallrave/pasurive të komunikojnë në mënyrë efektive për të shmangur mos zbatimin e kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurive.

3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Në fund të vitit 2015 Llogaritë e Arkëtueshme(LL/A) ishin 8,522,000€. Llojet kryesore të LL/A ndaj komunës janë: a) tatimi në pronë; b) qiraja dhe c) taksa në firmë . Në përgjithësi LL/A ishin rritur krahasuar me vitin e kaluar. Pjesa më e madhe e borxheve të pa arkëtuara ka të bëjë me tatimin në pronë (rreth 7.2milion) ku rritja ishte 2,8% krahasuar me vitin paraprak. Sistemi i tatimit në pronë menaxhohet nga Departamenti Qëndror i Tatimit në Pronë, pranë MF. Me ligjin për amnistimin e borxheve, është përfshirë edhe falja e tatimit në pronë. Si rrjedhojë, për shkak të ndryshimeve që po bëhen në sistem, nuk gjenerohen raporte të konsoliduara dhe analitike që nga nëntëmujori 2015. Meqë, transaksionet e ndodhura në fundvit, nuk konsiderohen materiale, kjo nuk e ka penguar punën për marrjen e sigurisë nga kjo fushë e të hyrave. Për pjesën tjetër të të llogarive të arkëtueshme, mangësitë ishin si vijon:

Çështja 16 - Mangësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme - Prioritet i lartë

E gjetura

Sa i përket evidentimit të llogarive të arkëtueshme nga taksat në biznes, komuna nuk kryen mbikëqyrje të këtyre llogarive. Vitin e kaluar vlera ishte 1,193,000€ derisa këtë vit është deklaruar 622,000€ dhe inkasimi këtë vit ishte rreth 51,561€. Kjo diferencë e lartë mes viteve është konfuze dhe ne nuk ishim në gjendje të qartësojmë këtë me komunën. Kjo mund të jetë rezultat i faljes së borxheve, por mungojnë të dhëna historike të detajuara për borxhet e pambledhura.

Përkundër rekomandimit tonë, për përmirësim të menaxhimit të procesit të qiradhënies, dobësitë vazhdojnë edhe këtë vit:

- ende zbatohen qiradhënie me kontrata të skaduara;
- në dy raste të lëshimit të pronave me qira, nuk ekzistojnë fleta poseduese për të adresuar legjitimitetin e pronësisë së komunës ndaj atyre qiradhënies;
- qiramarrësit shfrytëzojnë pasuritë komunale pa kryer obligimet e qirasë;
- jo të gjithë shfrytëzuesit aktiv të pronave komunale janë përfshirë në regjistrat e qirave dhe nuk arkëtohen të hyra nga këto prona;
- në PVF ka pasur paraqitje jo të saktë të vlerave. Një nga llogaritë për qira ishte mbivlerësuar për 1,080€. Pagesa të bëra në dhjetor 2015, nuk janë azhurnuar në databazën e llogarive të arkëtueshme.

Rreziku Paraqitja jo e saktë e shpalosjeve shpie në një keq pohim të pozitës financiare të komunës dhe në vitet në vijim mund të ndikojë opinionin e auditimit. Shfrytëzimi i pronave komunale në mungesë të kontratave valide, përveç që është në kundërshtim me ligjin, rrit rrezikun që këta shfrytëzues të refuzojnë obligimin financiar ndaj komunës dhe këto të hyra të mos inkasohen. Më tej, qytetarët të cilat kanë paguar obligimet ndaj komunës pa bazë kontraktuale, mund të kenë pretendime ndaj këtyre mjeteve, tashmë të paguara.

Rekomandimi 17 Kryetarja të sigurojë se drejtorja për zhvillim ekonomik mbikëqyrë mjaftueshëm historikun e taksave në biznes. Shpalosjet në pasqyra, vitin e ardhshëm t'i nënshtrohen një kontrolli detal dhe të vëhen kontrole të dukshme në mbarëvajtjen e qiradhënieve. Çdo qiradhënie të mbështetet me bazë të fortë kontraktuale dhe realizimi i saj të mbikëqyret në vazhdimësi..

3.7.3 Trajtimi i borxheve

Obligimet e papaguara të paraqitura në PVF 2014 ishin 3,269,028€, prej të cilave shuma prej 1,907,648€ paraqesin obligime vetëm me raporte të pranimit. Për periudhën e njëjtë 2015 obligimet janë 2,490,754€ nga të cilat me raporte të pranimit ishin 1,386,246. Mangësitë e identifikuar gjatë testimeve tona janë si me poshtë:

Çështja 17 - Evidentimi dhe raportimi i borxheve - Prioritet i mesëm

E gjetura Shkaku i mos protokolimit të të gjitha faturave të pranuar, janë identifikuar kontrole të pamjaftueshme në evidentimin e obligimeve ndaj OE. Gjithashtu, mungesa e një raportimi të strukturuar dhe formal në mes të drejtorive dhe Zyrtarit Kryesor Financiar, në baza mujore, ndikon që faturat e papaguara të mos raportohen me kohë. Kemi vërejtur që një faturë në shumë 19,456 € e datës 19.12.2014, paguar në vitin 2015, nuk ishte paraqitur në PVF 2014.

Rreziku Mos protokolimi i të gjitha faturave dhe rrugët jo formale të komunikimit mes drejtorive dhe ZKF-së rrezikon identifikimin dhe raportimin e saktë dhe të plotë të obligimeve financiare. Shpalosjet e pasakata të obligimeve paraqesin një pasqyrë jo të drejtë të pozitës financiare të komunës dhe mund të rezultojë me propozime jo adekuate gjatë procesit të buxhetimit.

Rekomandimi 18 Kryetarja duhet të instaloj sistem të protokolimit të çdo fature të pranuar nga komuna. Po ashtu, të siguroj se konfirmime formale për faturat e papaguara bëhen nga departamentet përgjegjëse ndaj kërkesave të ZKF-së.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetarja duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimi të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuar	Të adresuara por jo të implementuar	Të pa adresuara
Pasqyrat Financiare dhe rreziqet sinjifikante	Regjistrimi i pasurive komunale në SIMFK dhe në pajtueshmëri me rregulloren 02/2013. Të identifikohen arsyet për gabime në pasqyra dhe keqklasifikime. Të përmirësohet procesi i rishikimit të PVF-ve për vitin 2015 në mënyrë që të sigurohet se gabimet korigjohen para dorëzimit të PVF-ne në Qeveri.		Pjesërisht – Pasuria komunale ende të proces të identifikimit dhe zgjidhjes së kontesteve pronësore. Pjesërisht - Pjesa e shpalosjes së keq klasifikimeve nuk është bërë si dhe adresimi i çështjes së palëve të treta.	
Rekomandimet e vitit paraprak	Plan veprimi i rishikuar, për adresim të rekomandimeve të pa-adresuara të vitit 2013, së bashku me rekomandimet e 2014, të përcaktojë një orar të qartë të zbatimit të tyre.		Pjesërisht Nuk monitorohet formalisht zbatimi i rekomandimeve. Disa nga rekomandimet kanë mbetur të pa zbatuara.	
Vendimet gjyqësore dhe ekzekutimi i pagesave nga Thesari	Me rastin e hartimit të buxhetit, të githa detyrimet të parashikohen me buxhet, si dhe të forcoj disiplinën financiare që të gjitha obligimet të paguhen me kohë.		Pjesërisht Komuna ka reduktuar dukshëm bilancin e obligimeve financiare, por meqënëse shumë OE ende janë pretendues për kompenzim për punët e kryera vite më parë, Komuna ende i nënshtrohen këtyre pagesave përmes Thesarit dhe vendimeve gjyqësore.	

Të hyrat	<p>Zbatimi i ankandit publik tek qiradhëniet dhe masat për mbledhjen e borxheve të mbetura.</p> <p>Të bëhet një analizë gjithëpërfshirëse për ngecjet në zbatimin e rekomandimit për eliminimin e dobësive në menaxhimin e të hyrave. Të sigurohet një planifikim të mirëfilltë dhe inkasim efektiv.</p> <p>Mjetet e mbledhura nën 10€ të dërgohen tek arka në mënyrë që ato mjete të deponohen në llogarinë e komunës.</p>	Po	Pjesërisht - Analiza e kapaciteteteve inkasuese nuk është bërë për çdo zë të të hyrave vetjake.	Jo
Prokurimi	<p>Zhvillimi i procedurave të bëhet konform kërkesave LPP në mënyrë që të shpërblehen me kontratë vetëm OE të përgjegjshëm.</p> <p>Procesi i menaxhimit të kontratave të jetë më efektiv dhe për të gjitha vonesat, të parashikohen dhe zbatohen penalet, si masë për implementimin e kontratës, si dhe të mos bëhet vazhdimi i afatit të kontratave publike kornizë</p>			Jo Jo
Shpenzimet tjera	<p>Vëmendja tek shpenzimi i fondeve publike për nevojat të servisimit të automjeteve private, për të parë nëse rasti i ngritur paraqet rast të izoluar apo veprime të tilla kanë ndodhë edhe në automjetet tjera private.</p> <p>Të mos përsëritet praktika e paradhënieve, pos nëse është bërë rishikim rigoroz ku janë përjashtuar rreziqet që i shoqërojnë pagesat e tilla. Marrëveshjet për bashkëfinancim duhet</p>	Po	Pjesërisht – Çështja e ngritur me pagesat Europen Kosova nuk	

	t'i reflektojnë aranzhimet kontraktuale të cilat i ofrojnë komunës monitorim efektiv dhe kjo duhet të aplikohet sa më shumë të jetë e mundur tek marrëveshjet ekzistuese.		është trajtuar me rigorizitet nga komuna.	
Subvencione dhe Transfere	Forcimi i kontrolleve në zbatimin e procedurave për subvencione dhe të siguroj se ndarja e tyre bëhet në pajtim me kërkesat e rregullorej së brendshme.			Jo
Pasuritë	Një proces gjithëpërfshirës i regjitrimit të pasurive të vazhdoj dhe brenda një afati optimal të nxirret një regjistër përfundimtar mbi pasuritë komunale.		Pjesërisht Nuk është bërë konsolidimi i plotë i tyre ende janë pjesë e procedurave gjyqësore.	
Llogaritë e arkëtueshme	Inicimi i një procesi rivlerësimi, ku të gjitha Ll/A do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, mundësive reale për inkasim dhe duhet të siguroj vendosjen e një plani strategjik për zvogëlimin e tyre		Pjesërisht Edhe këtë vit janë ngritur për legjitimitetin dhe vlefshmërinë e Ll/A.	
Obligimet	Të shqyrtohen në mënyrë të hollësishme të gjitha obligimet e tanishme dhe ato të trashëguara, dhe të njëjtat të përfshihen në buxhetin vjetor në mënyrë që të parandalohet mundësia e pagesës nga ana e Thesarit.			Jo
Auditimi i brendshëm	Fokusi i auditimit të brendshëm të jetë shqyrtimi i aktiviteteve aktuale dhe parandalimi i gabimeve dhe parregullësive, dhe jo rishikimi i tyre pasi ato të kenë ndodhur. Çështja e themelit të Komitetit të auditimit duhet të konsiderohet.			Jo